NJOFTIM

MBI KANDIDATIN E PËRZGJEDHUR ANËTAR NË BORDIN E ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË DHE UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

Në zbatim ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë", dhe të urdhrit nr. 502, datë 06.10.2026, të ministrit të Arsimit "Për njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit", Ministria e Arsimit shpall kandidatët e përzgjedhur:

- Znj. Armela Baka, anëtar i Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.
- Z. Egert Hoxha, anëtar i Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.